



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 114 prot.

Kamëz, më 27.07.2022

V E N D I M

Nr. 27 Datë 27/07/2022

M B I

**“MIRATIMIN E MARRJES SË MJETEVE RRUGORE ME QIRA PËR NEVOJAT E BASHKISË KAMËZ”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 27.07.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.85 Datë 26.07.2022 Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 34, 40, 41, 54, 55; Ligjit nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligjit nr. 10 296 dt. 08.07.2010, “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligjit nr. 68/2017 dt. 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligjit nr. 9920 dt. 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar; Shkresës së MF nr. 23026 datë 22.12.2021 “Dërgohet Njoftim transfertat e Pakushtëzuar e përgjithshme dhe Sektoriale për vitin 2022”; Udhëzimin nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; Udhëzimin nr. 27 datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024”; Udhëzimin nr. 7 datë 28.02.2022, për një ndryshim në udhëzimin nr. 23 dt 23.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimin Plotësues nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”; VKB nr. 132 datë 22.12.2021 “Për miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2022, 2023, 2024”; kërkesës së administratorëve të njësive administrative dhe të lagjeve për marrje të mjeteve rrugore me qira për nevoja të Bashkisë; relacionit të grupit të punës për përcaktimin dhe miratimin e fondit limit me objekt “Marrje mjete rrugore me qira për nevojat e bashkisë”; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrjes me qira të mjeteve rrugore për nevojat e Bashkisë Kamëz.
2. Miratimin e marrjes me qira për 6 (gjashtë) automjete rrugore për administratën e Bashkisë Kamëz në vlerën 22,151,514 (njëzete e dymilion e njëqind e pesëdhjetë e njëmijë e pesëqind e katërmbëdhjetë) lekë, për një afat 3-vjeçar nga momenti i nënshkrimit të kontratës.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

3. Fondi për marrjen me qira të mjeteve rrugore për administratën e Bashkinë Kamëz për vitin 2022 në vlerën 3,076,599 ( tremilion e shtatëdhjetë e gjashtëmijë e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë ) lekë do të përballohet nga shpenzimet operative sipas strukturës buxhetore, Grupi 0, Programi 0110, Kapitulli 5, Artikulli 602
4. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI**

**Hysen KOLDASHI**

